



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government




Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike
Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost / Kosovo Academy for Public Safety

PLANI VJETOR I PERFORMANCËS

AKSP - 2025



Tetor, 2024

1. Përmbledhje Ekzekutive

Akademia e Kosovës për Siguri Publike /AKSP duke u bazuar në dispozitat përkatëse ligjore të parapara me Ligjin Nr. 06/L -113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, Rregullores (QRK) Nr. 12/2023 mbi sistemin e menaxhimit të performancës për agjencitë në kuadër të administratës shtetërore, ka hartuar këtë plan të performancës.

AKSP udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm i cili përfaqëson, organizon dhe koordinon punën e institucionit. Po ashtu Drejtori kryen të gjitha detyrat e Zyrtarit Kryesor Administrativ në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

AKSP-ja synon çdo herë t'i përcjellë dhe të jetë në hap me trendet e zhvillimit në fushën e sigurisë publike duke adaptuar mekanizmat e saj me qëllim të ngritjes së vazhdueshme profesionale të zyrtarëve të sigurisë publike. Plan i performancës i AKSP-së është adaptuar konformë kërkesave dhe nevojave të Institucioneve të Sigurisë Publike.

Ky dokument ka përcaktuar objektivat, aktivitetet dhe rezultatet me qëllim të implementimit të një politike efektive që do të ndërmerret në vitin 2025.

Fokusi i AKSP-së do të orientohet në avancimin e metodave dhe teknikave trajnuese, konsolidimin e arsimit të lartë dhe digjitalizimin e proceseve. Këto fusha janë me interes të veçantë për institucionin tonë sepse të gjitha këto kanë qëllimin e përbashkët avancimin e njohurive dhe kapaciteteve të Institucioneve të Sigurisë Publike.

Me qëllim të përmbushjes së misionit të saj, AKSP synon të realizojë objektivat e parapara në kuadër të planit të performancës për vitin 2025 si vijim:

- 1. Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve të sigurisë publike përmes trajnimeve**
- 2. Konsolidimi i arsimit të lartë në AKSP**
- 3. Digjitalizimi dhe automatizimi i proceseve të punës dhe infrastrukturës në AKSP**

Në kuadër të zbatimit të obligimeve të përcaktuara me këtë Plan të Përformancës për vitin 2025, AKSP ka paraparë veprimet dhe masat që do të ndërmerren në realizimin e këtij plani dhe do të sigurojë monitorim dhe raportim të rregullt periodik për të siguruar realizimin e objektivave të përcaktuara nga njësitë organizative.

Akademia e Kosovës për Siguri Publike për vitin 2025 ka të lejuar gjithsejtë njëqind e pesëdhjetë e gjashtë (156) pozita ndërsa momentalisht ka njëqind e njëzet e gjashtë (126) punonjës si dhe buxhetin e organizatës në total prej **3,383,632.99 €**. Po ashtu kemi pajisjet efektive teknologjike dhe logjistike për implementimin e objektivave të parapara në këtë plan.

2. Hyrje

AKSP u themelua në dhjetor të vitit 2011 me hyrjen në fuqi të ligjit Nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike/AKSP sipas të cilit AKSP-ja është agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme/MPB.

Misioni i AKSP është përcaktuar në bazë të ligjit Nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike/AKSP ku *AKSP është përgjegjëse për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë, zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit dhe të arsimit të lartë, si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike.*

AKSP i ofron shërbimet e lartpërmendura për të gjitha institucionet e sigurisë publike por pa u kufizuar vetëm në: Policinë e Kosovës(PK), Shërbimin Korrektues të Kosovës(SHKK), Doganat e Kosovës(DK), Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave(AME), Inspektoratin e Policisë së Kosovës (IPK) dhe Shërbimin Sprovues të Kosovës (SHSK).

Krijimi i dokumentit të Planit të Performancës ka filluar në fillim vit me diskutimin e projekt buxhetit ndërsa zyrtarisht me krijimin e grupit punues të institucionit duke përfshirë të gjitha njësit organizative të AKSP-së. Ky grup punues ka zhvilluar takime të shumta rreth formësimit të ideve dhe objektivave performuese të institucionit.

Plani performancës i AKSP-së për vitin 2025 është hartuar duke u bazuar në analizimin e gjendjes aktuale dhe proceseve në të cilat gjendet institucioni ku si rezultat janë përcaktuar edhe objektivat për avancimin dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të AKSP-së duke i ndërlidhur ato edhe me objektivat e dokumenteve tjera strategjike si:

→ **Strategjisë zhvillimore të AKSP-së 2023-2026**

→ **Standardet e Agjencisë së Kosovës për Akreditim, Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve dhe standardet ndërkombëtare akredituese IADLEST-SHBA.**

Trajnimi dhe arsimimi i zyrtarëve të sigurisë si faktor kyç në ngritjen e sigurisë publike është sfidë me shumë dimensionë. Andaj përmes këtij plani synojmë t'i avancojmë njohuritë dhe shkathtësitë e duhura për të gjithë pjesëtarët e Institucioneve të sigurisë publike duke u bazuar në **praktikat dhe standardet** më të mira vendore dhe ndërkombëtare në fushën e trajnimit dhe arsimit.

Të gjitha këto objektiva do të konkretizohen duke përcaktuar qartë planin e veprimit si pjesë përbërëse të dokumentit i cili parasheh orientimin dinamik dhe rezultatin konkret për secilin aktivitet.

3. Përmbledhje e Objektivave

Objektivat të cilat i kemi potencuar në përmbledhjen ekzekutive, kërkojnë veprime të vazhdueshme gjatë tërë vitit 2025, të cilat i kemi paraparë në planin e performancës. Me qëllim të përmbushjes së misionit dhe vizionit të saj, AKSP-ja synon të realizojë këto objektiva si në vijim:

Objektivi 1: Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve të sigurisë publike përmes trajnimeve

Mandati ligjor i AKSP është ofrimi i trajnimeve për zyrtaret e sigurisë publike. Me qëllim të përmbushjes së mandatit dhe avancimin e ofrimit të shërbimeve trajnuese kemi paraparë ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve të sigurisë publike përmes ofrimit të trajnimeve. AKSP është e përkushtuar në trajnimin e zbatuesve të ligjit në mënyrë që të pajisë dhe avancojë njohuritë dhe shkathtësitë e duhura duke u bazuar në **praktikat** dhe **standardet** më të mira vendore dhe ndërkombëtare në fushën e trajnimit për të gjithë pjesëtarët e institucioneve të sigurisë publike që u shërbejnë qytetarëve të Republikës së Kosovës për të qenë të sigurt në ambientet ku jetojnë dhe veprojnë. AKSP-ja po krijon standarde dhe mekanizma për ngritjen e cilësisë në politikat e trajnimit dhe arsimimit për zyrtarët e sigurisë publike falë bashkëpunimit dhe anëtarësimit në shumë organizata ndërkombëtare, akreditimeve vendore dhe ndërkombëtare, përkrahjes së vazhdueshme të partnerëve strategjik si ICITAP dhe OSBE.

Të gjitha këto do të përbëjnë një element të rëndësishëm të zhvillimit të vazhdueshëm profesional për zbatuesit të ligjit. Ngritja e kapaciteteve të Institucioneve të Sigurisë Publike bazuar në kërkesat dhe nevojat e Institucioneve të Sigurisë Publike dhe implementimi i obligimeve nga dokumentet e miratuara strategjike bazuar në **praktikat** dhe **standardet** më të mira vendore dhe ndërkombëtare në fushën e trajnimit.

Aktivitetet: Për arritjen e këtij objektivi nevojiten edhe shumë veprime dhe aktivitete të ndryshme të koordinuara dhe planifikuara si vijon:

- Implementimi i planit vjetor të trajnimeve
- Krijimi i trajnimeve të reja konformë trendeve të sigurisë publike, nevojave të ISP-ve dhe dokumenteve strategjike
- Realizimi i projektit me USFS-në e SHBA-së për ofrimin e Trajnimeve nga fusha e emergjencave
- Zhvillimi i trajnimeve të reja në fushën e luftimit të korrupsionit dhe pastrimit të parave
- Identifikimi dhe Krijimi i standardeve të reja profesionale
- Rishikimi i standardeve të trajnimeve profesionale të ISP-ve

Objektivi 2: Konsolidimi i arsimit të lartë në AKSP

AKSP ka për qellim që përmes ofrimit të arsimit të lartë të rrisë kompetencën profesionale të zbatuesve të ligjit. Adaptimi i politikave të mirëfillta arsimore-shkencore konformë standardeve akredituese dhe trendeve ndërkombëtare po ashtu janë faktorë që sigurojnë arritjen e qëllimeve strategjike në ngritjen e kapaciteteve të institucioneve të sigurisë publike në vend.

Përqendrimi kryesor i AKSP-së në kuadër të kësaj fushe është konsolidimi i arsimit të lartë përmes rishikimit të ofertës studimore konformë nevojave dhe sfidave të ISP-ve sepse harmonizimi i tij bazuar në ndjekjen e trendeve, zhvillimin dhe nevojave të institucioneve të sigurisë ndihmon institucionet e sigurisë për tu ballafaquar me dukuritë negative.

AKSP synon që përmes një politike arsimore që ka për bazë nevojat dhe interesat e ISP-ve, krijimin e kushteve dhe mundësive për të ndërtuar dhe zhvilluar njohuritë e studentëve/zyrtarëve të sigurisë publike, të kontribuoj në mënyrë konstruktive tek ISP-të të përballen me dukurit negative dhe arritjen e vlerave të kërkuara nga shoqëria.

Bashkërendimi i aktiviteteve me të gjithë akterët relevantë (Ministria e Punëve të Brendshme/MPB, Institucionet e Sigurisë Publike/ISP, Partnerët Ndërkombëtar/PN dhe Agjencinë e Kosovës për Akreditimit/AKA) mundëson që të ofrohet një arsim i duhur dhe kompetent për fushën e sigurisë publike.

Aktivitetet: Për arritjen e këtij objektivi nevojiten edhe shumë veprime dhe aktivitete të ndryshme të koordinuara dhe planifikuara si vijon:

- *Bashkërendimi i politikave rreth arsimit të lartë me akterët relevant (MPB, ISP, AKA, PN)*
- *Koncepti i arsimit dhe hulumtimit i hartuar mbi bazën e politikave të harmonizuara*
- *Hartimi i planit të përmirësimit duke përfshirë kërkesat akredituese*
- *Krijimi i programit studimor i profiluar sipas kërkesave dhe nevojave të sigurisë*

Objektivi 3: Digjitalizimi dhe automatizimi i proceseve të punës dhe infrastrukturës në AKSP

Ky objektivi është i hartuar duke u bazuar në analizimin e gjendjes aktuale dhe si rezultat janë përcaktuar mekanizmat kyç për avancimin dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të AKSP-së. Andaj përmes këtij plani /objektivi synojmë t'i avancojmë njohuritë dhe shkathtësitë e duhura duke aplikuar Teknologjinë Informative në trajnime, simulime elektronike, telekomunikuese etj., për të gjithë pjesëtarët e institucioneve të sigurisë publike duke u bazuar në praktikat dhe standardet më të mira vendore dhe ndërkombëtare në fushën e trajnimit dhe arsimimit.

Ky plan i performancës shërben si një plan për krijimin e një infrastrukture bashkëkohore dhe moderne si dhe digjitalizimin e shërbimeve që ofrohen në AKSP e cila plotëson nevojat dhe standardet më të mira për implementimin e trajnimeve dhe arsimit .

Kombinimi i proceseve të punës me trendet teknologjike tashmë shihet si domosdoshmëri dhe prioritet.

Aktivitetet: Për arritjen e këtij objektivi nevojiten edhe shumë veprime dhe aktivitete të ndryshme të koordinuara dhe planifikuara si vijon:

- *Zhvillimi i platformës së integruar softuerike për AKSP-së*
- *Instalimi i pajisjeve të zërimit për nevoja trajnuese, ceremoniale etj*
- *Avancimi i ligjërimit përmes pajisjeve teknologjike – SmartBoard*
- *Avancimi i shërbimeve të TI përmes rrjetave kompjuterike*
- *Rritja e sigurisë fizike në hapësirat e AKSP-së përmes digjitalizimit të proceseve / kontrolleve*
- *Funksionalizimi i qytetit simulativ*

4. Ndikimi buxhetor – Menaxhimi Financiar

Për realizimin e këtij plani të performancës për vitin 2025 sipas llogaritjeve të aktiviteteve nevojitet buxhet prej 1,048,416.30 € i cili është i aprovuar si draft buxhet dhe i shpërndarë në kode buxhetore të AKSP-së për vitin 2025, ku të gjitha aktivitetet e parapara në këtë plan të performancës janë të mbuluara dhe harmonizuara me buxhet të shpërndarë nëpër kode buxhetore sipas tabelës në vijim.

- ❖ AKSP për vitin 2024 sipas Ligjit të buxhetit për vitin 2024 dhe sipas Draft Ligjit për buxhet për vitin 2025 - Qarkores buxhetore 2025/02 për buxhet ka të lejuar buxhetin e përgjithshëm sipas kufijve buxhetore si më poshtë:

Tabela e buxhetit AKSP 2024		
AKSP - 2024	Kategoritë ekonomike	Buxheti i Aprovuar
	Paga & Mëditje	1,158,096.99
	Mallra dhe Shërbime	1,264,221.00
	Shpenzime Komunaleve	144,030.00
	Shpenzime Kapitale	817,285.00
	Total	3,383,632.99

Tabela e draft buxhetit AKSP 2025 Qarkore 2025/02		
AKSP - 2025	Kategoritë ekonomike	Buxheti i Aprovuar
	Paga & Mëditje	1,223,543.00
	Mallra dhe Shërbime	1,614,221.00
	Shpenzime Komunaleve	144,030.00
	Shpenzime Kapitale	817,285.00
	Total	3,799,079.00

AKSP-ja për vitin 2025 ka kërkuar edhe buxhet shtesë në vazhdimësi gjatë hartimit të propozimeve për Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve/KASH 2025-2027 për realizimin e disa objektivave të cilat janë vlerësuar si shumë të rëndësishme për proceset e AKSP-së si vijon:

- *Funksionalizimi i objektit të Fakultetit për Siguri Publike me furnizim me inventar dhe kabinete, laboratorë etj në vlerë 300,000.00 €.*
- *Shtesë në paga në vlerë 211,043.00 € për pozitat e pa plotësuara, transferimin e instruktorëve në AKSP (Ligji i AKSP-së ka përcaktuar që një pjesë e personelit trajnues të angazhohet nga institucionet e sigurisë publike si: PK, DK, SHKK, SHSK, IPK dhe AME në AKSP në periudha kohore deri në 3 vite), staf akademik i angazhuar, ekspert për trajnime, rrjeti mentorëve për intershipte etj.*
- *Kërkesa për furnizim me ushqim dhe pije për kadet në vlerë 1,000,000.00 €*
- *Mirëmbajtja e ndërtesave në vlerë 100,000.00€*

Pas shqyrtimeve dhe dëgjimeve buxhetore nuk kemi pasur ndonjë aprovim të kërkesave shtesë për vitin 2025 mirëpo sipas draft buxhetit për vitin 2025 kemi pranuar rritje buxhetore në dy kategori:

- ❖ **Kategoria paga dhe mëditje nga viti 2024 rritje në vlerë prej 64,446.01 € si dhe**
- ❖ **Kategoria Mallra dhe shërbime nga viti 2024 rritje në vlerë prej 250,000.00 €**

AKSP-ja është duke hartuar kërkesa për plotësimin e nevojave edhe me burime tjera financiare me donatorët, por ende nuk kemi asnjë projekt të miratuar për zbatim në vitin 2025.

A. Pjesa tabelore e Planit të Përformancës

Data		31/10/2024				
Agjencia		AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE				
Ministria përgjegjëse		MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME				
Misioni i Agjencisë		Misioni i Akademisë është të ofroj trajnim, arsimim dhe hulumtim me cilësi të lartë në fushën e sigurisë publike për të ndihmuar në ofrimin e ambientit të sigurte për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës				
Nr.	Objekti	Treguesit		Vlera bazë	Vlera e synuar	Referenca në dokumente strategjike/politike
1	Ngritja e kapaciteteve/përformancës së zyrtarëve të sigurisë publike përmes trajnimeve	Numri i trajnimeve profesionale për ISP		5 [2024]	5 [2025]	Strategjia zhvillimore AKSP 2023-2026
		Numri i zyrtarëve në trajnime profesionale		964 [2024]	1052 [2025]	
		Numri i zyrtarëve të sigurisë publike të trajnuar		1548 [2024]	2060 [2025]	
Aktivitetet kryesore		Njësia përgjegjëse	Afati i zbatimit	Alokimi financiar	Burimi i financimit	Outputet/ Produkti
1.1. Implementimi i planit vjetor të trajnimeve		DTPA	K1-K4	885.516.30 €	Buxheti RKS	Organizimi dhe mbajtja e mbajtja e trajnimeve sipas planifikimit të trajnimeve vjetore
1.2. Zhvillimi i trajnimeve të reja në fushën e luftimit të korrupsionit dhe pastrimit të parave		DTPA	K1-K4	1,000 €	Buxheti RKS Donatorët	Së paku dy (2) trajnime të zhvilluara
1.3. Krijimi i trajnimeve të reja konform trendeve të sigurisë publike, nevojave të ISP-ve dhe dokumenteve strategjike		DTPA	K1-K4	1,000 €	Buxheti RKS	Së paku tre (3) trajnime të reja të zhvilluara
1.4. Realizimi i projektit me USFS-në e SHBA-së për ofrimin e Trajnimeve nga fusha e emergjencave		DTPA	K1-K4	900 €	Buxheti RKS Donatorët	Së paku 2 trajnime të realizuar në fushën e Emergjencave në bashkëpunim me projektin USFS-SHBA
1.5. Identifikimi dhe Krijimi i standardeve të reja profesionale		DTPA/DSC	K1-K3	Kosto administrative	Buxheti RKS	Identifikimi i standardeve të reja Krijimi i grupit punues për krijimin e standardeve të profesionit Draftimi i së paku një (1) standardi të profesionit

1.6. Rishikimi i standardeve të trajnimeve profesionale të ISP-ve		DTPA/DSC	K1-K4	Kosto administrative	Buxheti RKS	Standardet profesionale të rishikuara dhe miratuara nga Bordi AKSP për 6 ISP-të
Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 1:					888,416.30 €	
Nr.	Objektivi	Treguesit		Vlera bazë	Vlera e synuar	Referenca në dokumente strategjike/politike
2	Konsolidimi i arsimit të lartë në AKSP	Koncepti institucional dhe programor i hartuar		0	1	Strategjia Zhvillimore e AKSP 2023-2026
		Arsimi i lartë i konsoliduar për aplikim në AKA		0	1	
Aktivitetet kryesore		Njësia përgjegjëse	Afati i zbatimit	Alokimi financiar	Burimi i financimit	Outputet / Produkti
2.1. Koncepti i arsimit dhe hulumtimit i hartuar mbi bazën e politikave të harmonizuara		FSP	TM1	Kosto administrative	Buxheti RKS	Koncepti i arsimit dhe Plani i qëndrueshmërisë i hartuar
2.2. Bashkërendimi i politikave rreth arsimit të lartë me akterët relevant (MPB, ISP, AKA, PN)		AKSP/MPB/ISP/PN	TM1	Kosto administrative	Buxheti RKS	Politikat e harmonizuara me akterët
2.3. Hartimi i planit të përmirësimit duke përfshirë kërkesat akredituese		FSP	TM2	Kosto administrative	Buxheti RKS	Plani i përmirësimit i hartuar Zhvillimi i dokumenteve relevante Plotësimi i pozitave me staf akademik sipas kërkesave të AKA
2.4. Krijimi i programit studimor i profiluar sipas kërkesave dhe nevojave të sigurisë		FSP	TM3	Kosto administrative	Buxheti RKS	Programi studimor i hartuar Aplikacioni i dorëzuar në AKA
Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 2:					00 .00 €	
Nr.	Objektivi	Treguesit		Vlera bazë	Vlera e synuar	Referenca në dokumente strategjike/politike
3	Digjitalizimi dhe automatizimi i proceseve të punës dhe infrastrukturës në AKSP	Zhvillimi i platformës Softuerike		0 (2024)	1 (2025)	Strategjia Zhvillimore e AKSP 2023-2026
		Funksionalizimi i qytezës simulative		0 (2024)	1 (2025)	
Aktivitetet kryesore		Njësia përgjegjëse	Afati i zbatimit	Alokimi financiar	Burimi i financimit	Outputet / Produkti

3.1. Zhvillimi i platformës së integruar softuerike për AKSP-së	DFSHP-DTI	TM1	65.000 €	Buxheti RKS	Digjitalizimi dhe automatizimi i proceseve dhe shërbimeve dhe integrimi i bazave aktuale të dhënave.
3.2. Instalimi i pajisjeve të zërimit për nevoja trajnuese, ceremoniale etj	DFSHP-DTI	TM2-TM4	20.000 €	Buxheti RKS	Pajisjet funksionale për paradën e kadetëve, pajisjet për BLEEP TEST në sallën e sportit, pajisjet e zërimit në qendrën mësimore ST Bennet.
3.3. Avancimi i ligjërimit përmes pajisjeve teknologjike – Smart Board	DFSHP-DTI	TM2-TM4	50.000 €	Buxheti RKS	Avancimi i ligjërimit nga niveli klasik në nivelin me smartboard dhe integrimi shërbimeve ligjëruese në një pajisje.
3.4. Avancimi i shërbimeve të TI përmes rrjetave kompjuterike	DFSHP-DTI	TM2-TM4	10.000 €	Buxheti RKS	Avancimi i infrastrukturës së rrjetave kompjuterike duke instaluar pajisje të reja (Switch-a PoE, Router-a, panele, switch-a optik, Servera etj)
3.5. Rritja e sigurisë fizike në hapësirat e AKSP-së përmes digjitalizimit të proceseve / kontrolleve	DFSHP-DTI	TM2-TM4	5.000 €	Buxheti RKS	Avancimi i sigurisë fizike në AKSP përmes instalimit të rampave elektronike, dorëzave elektronike etj.
3.6. Funksionalizimi i qytetit simulativ	DFSHP	TM2-TM4	10.000€	Buxheti RKS	Funksionalizimi i Qytezës simulative për nevojat trajnuese (ushtrimeve operacionale- praktike)
Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 3:				160,000.00 €	

U.d. Drejtori i
Përgjithshëm i AKSP-së

Shpend Shabani

Ministri i MPB-së

Xhelal Svecla

